VENDIM
Nr. 421, datë 13.5.2015

PËR PROCEDURAT E SHQYRTIMIT TË KËRKESAVE, DOKUMENTACIONIN, AFATET E SHQYRTIMIT DHE KRITERET E VEÇANTA TË LICENCIMIT TË VEPRIMTARIVE TË LEJUARA ME ARMËT

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 3, të nenit 19, të ligjit nr. 74/2014, "Për armët", me propozimin e ministrit të Punëve të Brendshme, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

I. TË PËRGJITHSHME

1. Policia e Shtetit bën licencimin e veprimtarisë së personave fizikë e juridikë në fushën e veprimtarisë së lejuar me armët.

2. Autoriteti i Kontrollit Shtetëror të Eksporteve (AKSHE) autorizon subjektet e licencuara nga Policia e Shtetit për import/eksport dhe tregtim të armëve të kategorive "B1", "B4", "C" dhe "D".

AKSHE shqyrton kërkesën e subjekteve për import/eksport", vetëm për armët e kategorive "B1" dhe "B4", sipas legjislacionit në fuqi.

II. DOKUMENTACIONI QË PARAQET KANDIDATI PËR T'U PAJISUR ME LICENCË

3. Për t'u pajisur me licencë për veprimtaritë e lejuara me armë, titullari i subjektit paraqet në strukturën e policisë këto dokumente:

a) Formular aplikimi & autodeklarim për certifikimin/licencimin/autorizimin;

b) Vetëdeklarim "Për verifikimin e gjendjes gjyqësore";

c) Letërnjoftim i njohur sipas legjislacionit në fuqi;

ç) Certifikatë regjistrimi të subjektit në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit, bashkëlidhur ekstraktit të gjendjes aktuale, lëshuar nga Qendra Kombëtare e Regjistrimit sipas legjislacionit në fuqi;

d) Kontratë pune me drejtuesin teknik;

dh) Certifikatën e drejtuesit teknik të subjektit;

e) Raportin mjekësor, që vërteton se është i aftë nga ana mendore dhe fizike;

ë) Fotografi të aplikuesit, 4 copë.

III. PROCEDURAT PËR PRANIMIN, VERIFIKIMIN DHE SHQYRTIMIN E DOKUMENTACIONIT

4. Për pranimin, verifikimin dhe shqyrtimin e dokumenteve për licencim nga strukturat përkatëse të policisë ndiqet kjo procedurë:

a) Specialisti përkatës i policisë, i ngarkuar me detyrën e pranimit të dokumenteve, kërkon nga personi fizik ose subjekti plotësimin e formularëve përkatës sipas rubrikave;

b) Seksioni për krimet verifikon besueshmërinë dhe përgatit dokumentin e besueshmërisë dhe përshtatshmërisë së personit, brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve;

c) Specialisti i policisë dhe i armatimit inspekton në vend objektin dhe verifikon kushtet teknike e të sigurisë. Pas verifikimit përpilon raportin përkatës nëse objekti i plotëson kushtet apo jo sipas përcaktimeve në rregulloren e sigurisë;

ç) Struktura përkatëse në Drejtorinë e Policisë së Shtetit verifikon dokumentacionin e ardhur për subjektet që kanë aplikuar për licencë në fushën e veprimtarisë me armët dhe i paraqet në komisionin qendror të shqyrtimit të kërkesave për licencim të subjekteve për veprimtaritë e lejuara me armët;

d) Vetëdeklarimi i dërgohet strukturës përkatëse për verifikimin e gjendjes gjyqësore;

dh) Komisioni qendror i shqyrtimit të kërkesave për licencim dhe certifikim mblidhet çdo muaj,

shqyrton dokumentacionin e grumbulluar për pajisjen me licencë dhe vendos miratimin/refuzimin e licencës.

5. Në përfundim të shqyrtimit të kërkesës, komisioni qendror përgatit vendimin dhe ia paraqet për nënshkrim Drejtorit të Policisë së Shtetit.

6. Refuzimi i dhënies së licencës bëhet me vendim të arsyetuar dhe të interesuarit i kthehet përgjigje me shkresë.

7. Për rastet e kërkesave për përsëritje të licencës bëhet vlerësimi i performancës dhe ligjshmërisë së aktivitetit të subjektit gjatë periudhës së mëparshme të licencimit. Kërkesa për përsëritje bëhet 90 (nëntëdhjetë) ditë para përfundimit të afatit të licencës që ka në përdorim.

8. Afati i përgjithshëm i procedurës për njoftimin e kërkuesit për licencim është 90 (nëntëdhjetë) ditë.

9. Afati i vlefshmërisë së licencës është 5 (pesë) vjet.

IV. KRITERET E VEÇANTA TË LICEN-CIMIT

10. Personat dhe subjektet që kërkojnë të licencohen duhet të plotësojnë kriteret e përcaktuara në nenin 34, të ligjit nr. 74/2014, "Për armët".

11. Krahas kritereve të përgjithshme të përcaktuara në ligjin nr. 74/2014, "Për armët", subjekti duhet të plotësojë edhe këto kritere të veçanta për ushtrimin e veprimtarisë së lejuar me armë:

a) Për ushtrimin e veprimtarisë së tregtimit dhe import-eksportit të armëve të kategorive "B1", "B4", "C" dhe "D", të ketë një ambient të përshtatshëm për ushtrimin e aktivitetit sipas kushteve të miratuara me rregullore, në pronësi apo përdorim për pesë vitet në vazhdim.

b) Për ushtrimin e veprimtarisë së transportit të armëve, pjesëve dhe municioneve të armëve të kategorive "B1", "B4", "C" dhe "D", të zotërojë automjete sipas kushteve të përcaktuara në rregullore.

c) Për ushtrimin e veprimtarisë për poligon civil qitjeje, ndërtimi dhe mënyrën e funksionimit të ambienteve, të plotësojë kushtet e sigurisë të miratuara me vendim të Këshillit të Ministrave, në pronësi apo përdorim për pesë vitet në vazhdim.

ç)Për ushtrimin e veprimtarisë për aftësimin teorik dhe praktik për armët, të ketë një ambient të përshtatshëm për ushtrimin e aktivitetit sipas kushteve të miratuara me rregullore, në pronësi apo përdorim për pesë vitet në vazhdim, dhe poligon civil qitjeje.

V. TË FUNDIT

12. Ngarkohen Ministria e Punëve të Brendshme dhe Ministria e Mbrojtjes për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama